

## **WORKSHOP-I ME TEMË “PLANIFIKIMI I VEPRIMTARISË AUDITUESE PËR VITIN 2025” TË DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË BUXHETIT TË SHTETIT DHE DEPARTAMENTIT TË AUDITIMIT TË VETËQEVERISJES VENDORE**

Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 11.09.2024, “Për përgatitjen e planit të audituesve të KLSH për vitin 2025” të Kryetarit të KLSH-së, më datë 05.11.2024 në ambientet e Universitetit “Luigj Gurakuqi” në Shkodër, u organizua Workshop-i me temë “Planifikimi i veprimtarisë audituese për vitin 2025” të Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Fjalën përshëndetëse të këtij Workshop-i e mbajti Sekretari i Përgjithshëm i KLSH, znj. Valbona Gaxha, e cila pasi falenderoi mikpritjen e stafit të universitetit, Rektorin z. Tonin Gjuraj, Dekanen e Fakultetit Ekonomik znj. Elidjana Pema, pedagogë si dhe studentë pjesëmarrës në takim, theksoi rëndësinë e këtij takimi në vazhden e aktiviteteve të Planit Strategjik të KLSH-së. Në fjalën e saj ajo u përqendrua në punën audituese të KLSH, Raportet Përfundimtare të Auditimit të cilat pasqyrohen në faqen e web-it të KLSH për opinionin e gjerë, tashmë duhet të bëhen transparentë edhe në takime të tilla, me studentë e pedagogë. Më pas, znj. Gaxha u shpreh se dyert e Kontrollit të Lartë të Shtetit janë të hapura për studentët të cilët janë të interesuar që pasi të mbarojnë studimet të konkurrojnë për t’u bërë pjesë e KLSH-së.

Në fjalën përshëndetëse Rektori i Universitetit, z. Tonin Gjuraj falenderoi Kryetarin e KLSH z. Arben Shehu, i cili ka zgjedhur auditorin e Universitetit “Luigj Gurakuqi” për të paraqitur punën audituese të KLSH-së. Ai bëri një panoramë të shkurtër të numrit të studentëve që ndiqnin vitin akademik 2024-2025. Gjithashtu theksoi rëndësinë që ka ky takim për të dyja palët, pasi dhënia e mendimeve dhe diskutimeve u vlen pedagogëve e studentëve në fushën akademike, por edhe audituesve të KLSH-së në këndvështrimin e tyre për punën audituese.



Më pas, fjalën përshëndetëse në takim e mori Dekani i Fakultetit Ekonomik znj. Elidjana Pema, e cila theksoi se në universitetin e tyre, kishin degën e auditimit në Programe Master duke shprehur kështu edhe rëndësinë që ka formimi akademik për fokusin e mëtejshëm të karrierës.

Znj. Joana Troqe, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit mbajti fjalën e saj fokusuar mbi metodologjinë e planifikimit të auditimeve në KLSH dhe veçanërisht planifikimin e auditimeve të DABSH.

Në diskutimet që u zhvilluan me të pranishmit pas prezantimit, pedagogët ju drejtuan me pyetje drejtuesve të KLSH lidhur me aspekte të ndryshme të veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Më pas, z. Bledar Doracaj Drejtor i Departamentit të Vetëqeverisjes Vendori mbajti fjalën mbi planifikimin e auditimeve në DAVV.

Në pjesën e dytë të aktiviteti u zhvilluan diskutime të ndryshme rreth planifikimit të DABSH dhe DAVV. Kryeaudituesi z. Alush Zaçe foli rreth domosdoshmërisë për rritjen e cilësisë së auditimit, mënyrën e shkrimit duke u bazuar në Udhëzuesit e KLSH, qasja e audituesve të rinj pa eksperiencë me audituesit me eksperiencë në grupe pune etj.

Më pas fjalën e mbajti z. Altin Dinaj auditues nga DABSH, mbi procedurat e planifikimit të Sektorit të Auditimit të të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, si dhe propozime mbi auditimet që mund të zhvillohen gjatë vitit 2025. Z. Rigels Guzi auditues nga DABSH bëri një panoramë të shkurtër, mbi procedurat e planifikimit të Sektorit të Auditimit Llogarive të Buxhetit të Shtetit. Pas tij, e morën fjalën me radhë auditues të tjerë të këtij departamenti mbi propozimet e tyre që lidheshin jo vetëm me përfshirjen në planin e DABSH, por edhe mbi bashkëpunimet ndër departamentale, si dhe kryerja e auditimeve me bazë sistemi për problematika të caktuara, si një mjet më efektiv për analizimin e problematikave dhe përgatitjen e rekomandimeve përkatëse.



Në fund znj. Gaxha Sekretar i Përgjithshëm në KLSH, shprehu edhe njëherë rëndësinë që pati ky Workshop, pasi u diskutuan problematika të mbartura por edhe të reja të cilat do të shikohen me përparësi.